



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E PROKURIMIT PUBLIK
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot.

Fier, më __.06.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje kancelari dhe letër”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

30192130-1 - Lapsa, 30192124-6 – Stilolapsa ; 22852000-7- Dosje; 30141100-0 - Makina llogaritëse; 30192125-3 -Shënues ; 30197220-4 -Kapese letrash; 30197630-1 - Letër printimi; Kompakt disqe (cd)- 30234300-1

VLERA E FONDIT LIMIT: 5 833 333 (*pesë milion e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre*) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Bashkia Fier, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar në nenin 76 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik“, i ndryshuar dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2024, 2025**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më pak se **2 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me:

-Pikën 3 të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, ”Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: ”3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.;

-Pikën 1 dhe pikën 2/c të nenit 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Pika 1. ”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimale deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.”

Pika 2/c: “2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;*”

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që autoriteti kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorit ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga autoriteti kontraktor. Kriteri i mësipërm është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/c e nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në procedurën e hapur të thjeshtuar, përkatësisht; Pika 2/c: “2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;* Duke qënë se kjo procedurë prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit nën kufirin e ulët monetar, autoriteti kontraktor, duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara më parë gjykon se është e përshtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në legjislacionin dhe rregullat e prokurimit publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare*”.

Në vendosjen e këtij kriteri është mbajtur në vëmendje neni nr. 61 të Ligjit nr.29/2023 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” si dhe rekomandimit të APP-së nr. 7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin me sukses të kontratës dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se **1 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së

përlllogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për këtë pikë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një nga dokumentat e mëposhtëm:

- a- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40, pika 4 dhe nenit 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se **1 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet) që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pikën 4 të nenit 40 dhe pikën 4/b të nenit 55 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë teknike të operatorit ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet përvojës së mëparshme, se zotërojnë kapacitetet dhe aftësinë teknike për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga autoriteti kontraktor.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi për zërin me nr. Rendor 52 ”Letër fotokopje A4”. Në rast se do të paraqitet Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi, duhet të provohet dhe lidhja midis prodhuesit dhe Distributorit të autorizuar. Secili nga dokumentat duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave, si dhe origjinale ose fotokopje të përkthyera dhe të noterizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar nga grupi i punës e ngritur me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor me nr.4854 prot datë 16.04.2026, bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku citohet: *”Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b. fotografitë apo katalogët teknikë”*. Grupi i punës argumenton se kjo kërkesë ka për qëllim garantimin e origjinës, cilësisë dhe furnizimit të rregullt të produkteve që do të ofertohen dhe kontraktohen.

Këto produkte janë materiale konsumi të përdorimit të vazhdueshëm në veprimtarinë e institucionit dhe cilësia e tyre ndikon drejtpërdrejt në funksionimin normal të pajisjeve të printimit dhe fotokopjimit, si dhe në cilësinë e dokumentacionit të prodhuar. Për këtë arsye, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet që produktet e ofruara janë origjinale, përmbushin standardet e kërkuara teknike dhe sigurohen nëpërmjet kanaleve zyrtare të shpërndarjes.

Në rastet kur autorizimi paraqitet nga distributori i autorizuar, kërkohet gjithashtu dokumentacion që provon lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit të autorizuar, me qëllim verifikimin e vlefshmërisë së autorizimit dhe garantimin e zinxhirit të furnizimit. Kjo kërkesë synon të shmangë paraqitjen e autorizimeve të pavlefshme ose të paautorizuara dhe të garantojë se operatori ekonomik ka akses të ligjshëm në produktet objekt prokurimi

Gjithashtu, për arsye të përdorimit të lartë dhe specifikës së këtij artikulli, si dhe pamundësisë për të evidentuar qartë specifikimet teknike është e nevojshme paraqitja e autorizimit nga prodhuesi/distributori i autorizuar me qëllim që autoriteti kontraktor të ketë garanci që së pari do të ketë në dispozicion mallin në kohën dhe sasinë e duhur dhe së dyti ky mall do të jetë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë skedë teknike/katalog/broshurë ose fragment katalogu ose broshurë nga prodhuesi për zërin me nr. 52, “Letër fotokopje A4”, që përmban të dhëna dhe specifikime teknike të artikullit me numer rendor nr.52 “Letër fotokopje A4”, të cilat duhet të jenë në përputhje me karakteristikat apo specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor, për këtë artikull. Në rastin kur skeda teknike/ katalog/broshurë ose fragment katalogu ose broshurë është në gjuhën shqipe, nuk ka nevojë të përkthehet dhe noterizohet por në rastin kur është në gjuhë të huaj duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar nga grupi i punës e ngritur me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor me nr.4854 prot datë 16.04.2026, bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku citohet: *”Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b. fotografitë apo katalogët teknikë;”*

Paraqitja e katalogeve është kërkuar me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së mallrave që operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike të përcaktuara në DST.

2.3.4 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin mostrat (*kampionët*) **për disa prej artikujve të kërkuar si më poshtë**, në ditën e hapjes së ofertave, në orën dhe vendin e caktuar në dokumentat e tenderit.

- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues.
- Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.
- Mostrat do të dorëzohen përpara komisionit, në orën dhe datën e përcaktuar për hapjen e ofertave, në Sallën e Mbledhjeve të Bashkisë Fier, Kati II, Lagjja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Nr.15, Fier.

Lista e artikujve për të cilët kërkohen mostra është si më poshtë:

NR	Emertim + Specifikim	Njësia	Sasia
1	Stilolaps me maje rapid , 03-04 mm ngjyre blu. Te mos zbehet dhe te mos leshoje njolla.	cope	1
4	Rapidograf me maje 0.8 mm ngjyre blu. Te mos zbehet dhe te mos leshoje njolla.	cope	1
12	Blllok axhende ditore me permasa 17.2 x 24 cm +/- 2 %, me minimumin 320 faqe dhe me mbajttese stilolapsi.	cope	1
15	Zarfa te vegjel 11 x 23 cm me shirit per ngjitje .	cope	1
19	Zarfa 23x33. 120gr me pjeta, me fund kuadratik, ngjyre kafe	cope	1
20	Zarfa 30x44 cm me fluska ajri brenda	cope	1
22	Dosje me buton, plastik ose ekuivalent rezistente ndaj lageshtires, me gjeresi min 20cm, me doreze dhe me xhep per etikete shenimesh. Dosja ka edhe unaze qe e bene me te lehte terheqjen e saj.	cope	1
23	Dosje me llastik. Llastiku te jete i gjere minimum 1.2cm dhe dosja te jete afersisht 6 cm e gjere.	cope	1
27	Dosje me mekanizem dhe me kuti 5 cm, ne lartesi 32-34cm. Dosja dhe kutia duhet te jene te veshura me nje cip te holle me relief ne prekje ose ekuivalent, qe sherbejne per te mos reshqitur dosjen gjate terheqjes . Dosja duhet te kete unaze per terheqjen e saj.	cope	1
29	Leter posit me ngjitje 76x76 +/- 2%, me 500 flete, minimumi me 5 ngjyra te ndryshme	cope	1
30	Leter posit me ngjitje 76x127 +/- 2%, me 500 flete, minimumi me 5 ngjyra te ndryshme	cope	1
36	Qeska plastike per leter A4 (pako 100 copeshe) ose ekuivalente	pako	1

52	<p>Leter fotokopje A4</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ E pajisur me certifikate cilesie ISO 9001 ▪ Gramatura nominale , 80 gr/m2 me nje rizem (500 fije x A4) ▪ Permasat : 210x 297mm ▪ Pesha baze: 80gr/m2 ▪ Lageshtira: 3.0-4.0% ▪ Trashesia : 103-110 µm ▪ Ashpersia ne perkulje : MD >90mN ▪ Ashpersia ne perkulje : CD > 30mN ▪ Patejdukshmeria > 94% ▪ Shkelqimi :108-112% ▪ Bardhesia CIE 161-170 ▪ Amballazhimi : mbeshjtjellje kunder lageshtires dhe kuti me kapacitet 5 rizma ▪ Te plotesoj standartet qe letra te mbahet ne kohe te gjate ne arkiv , sipas ISO 9706 	pako/500 flete	1
68	Zarfa plastik A4 me vrime , me indeks dhe me mbajtese kartvizitash ose ekuivalente	cope	1
72	Tela kapse 24/6	kuti	1

Mos paraqitja e mostrës sipas specifikimeve teknike është kushtë për skualifikim.

Argumentimi: Referuar VKM nr 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 40, pika 6 është përcaktuar se:

“Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose.”

Ky kriter është përcaktuar nga strukturë e posacme/ grupi i punës e ngritur me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor me nr.4854 prot., datë 16.04.2026, i cili kërkohet për të siguruar Autoritetin Kontraktor që operatori ekonomik ka aftësi të përmbushë kërkesat e AK-së lidhur me specifikimet teknike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar dhe argumentuar nga grupi i punës i ngritur me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor me nr.4854 prot., datë 16.04.2026, dërguar me dokumentacionin teknik të ardhur me shkresë nr.7150/1 prot., datë 04.06.2026, me lëndë «Dërgim dokumentacioni për blerje kancelari dhe letër», si dhe në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Shënim: Në çdo rast ku është përdorur emri i markës/ produkte / origjinë në tabelën e preventivit me zërat dhe sasi të mallrave, përfshihet edhe termi “ose ekuivalente me të”.

Kriteret teknike të veçanta të kualifikimit pikat (2.3.2, 2.3.3, 2.3.4) janë hartuar e argumentuar nga grupi i punës e ngritur me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor me nr. nr.4854 prot., datë 16.04.2026.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT :

Lifter Muskaj

Klodiana Hoxhaj

Kristi Ndreko